

VENDIM
Nr. 13, datë 1.4.2026

**PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN “PËR PARANDALIMIN E
PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 9 dhe nenit 126, pika 2, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 60, pika 1, dhe nenit 66, të ligjit nr. 52/2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”; të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar; dhe të ligjit nr. 157/2013, datë 10.10.2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, miratuar me vendimin nr. 44, datë 10.6.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të ndryshuar, të bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

a) Në nenin 6, pas pikës 16 shtohet pika 17, me përmbajtjen e mëposhtme:

“17. Politikat, rregullat dhe procedurat e brendshme të hartuara nga subjektet për administrimin e rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje, miratohen nga organet drejtuese përkatëse të subjekteve.”.

2. Ngarkohen subjektet e kësaj rregulloreje me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko